



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.179 dt.27.11.1997

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, në mbledhjen tij të dt.27.11.1997, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës “Mbi rivlerësimin e studimit urbanistik të sheshit qëndror të Tiranës brenda dhe rreth Unazës së Vogël” të miratuar në K.RR.T. me vendimin Nr.530, dt.15.10.1997

**VENDOSI**

- I.** Të miratojë në parim rivlerësimin dhe studimin urbanistik të sheshit qëndror të Tiranës brenda dhe përreth Unazës së Vogël, me këto propozime :
1. Zonimi funksional i sheshit qëndror të jetë sipas variantit të III (i tretë) duke përcaktuar hapësirën në perëndim të zonës administrative (hapësira midis Ministrive dhe rrugës “Dëshmorët e 4 Shkurtit”) si zonë rezervë për ndërtim si dhe duke propozuar spostimin në prespektivë të Teatrit Popullor në një pozicion më të përshtatshëm.
  2. Pranohet konceptimi volumor dhe shpërndarja e tyre sipas propozimit të paraqitur .
  3. Njëra nga rrugët tregëtare( rruga e “Dibrës”) të trajtohet si rrugë muze me objekte karakteristike të Tiranës së vjetër.
  4. Sheshi qëndror i Tiranës të ketë karakter këmbësor.
  5. Të plotësohet varianti i IV (i katërt) i sistemit rrugor me nënkalimet nëntokësore të parashikuara në variantin e II (e dytë) të sistemit rrugor duke i dhënë prioritet realizimit të nënkalimeve këmbësore në një të ardhme të afërt.
  6. Realizimi i sistemit rrugor të fillojë (mundësisht që nga viti 1998) nga segmenti i Unazës së Vogël (rreth 250 gjatësi) që lidh Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” me rrugën e “Barrkadave” (mbrapa hotel “Tiranës”) dhe zgjerimet e

segmentit të rrugës “Dëshmorët e 4 Shkurtit” nga Banka tek Ministria e Mbrojtjes dhe segmentit të rrugës “Myslym Shyri” nga Ministria e Mbrojtjes tek Kuvendi Popullor.

7. Të plotësohet studimi me infrastrukturën përkatëse pas miratimit.
8. Të nxirret vlefata për gjithë Unazën e Vogël dhe t’i kërkohet qeverisë fonde duke filluar që nga viti 1998 me segmentin e përmendur më lart.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**